



REPUBLIKA E KOSOVËS

Republika Kosova – Republic of
Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut

Opština Južna Mitrovica – Municipality of
Mitrovica South



DATË/A:	07.08.2026
REFERENCË:	01-020/04-0038157-2/26-4
PËR/ZA/TO:	Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Jugut
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Faton Peci – Kryetar i Komunës znj. Arjeta Beqiri Hyseni – Drejtoreshë e Drejtorisë për Mbrojtjen e Mjedisit
NGA/OD/FROM:	Irfan Peci – Kryesues i Grupit Punues
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport – Procesi i konsultimit publik për Draft-Rregulloren për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 02/2022 për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe shfuqizimin e Rregullores Nr. 04/2023

Të nderuar,

Në përfundim të periudhës së konsultimit publik për Draft-Rregulloren për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 02/2022 për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe shfuqizimin e Rregullores Nr. 04/2023, paraqitet ky raport i zgjeruar për procedim të mëtejshëm në Kuvendin e Komunës.

Raporti përmbledh zhvillimin e diskutimit publik të mbajtur më 03.08.2026, përmbajtjen e prezantuar, çështjet e ngritura nga pjesëmarrësit, listën e nënshkruar të pjesëmarrjes, foto-dokumentimin nga Salla e Kuvendit, si dhe komentet e pranuar me e-mail deri më 07.08.2026.

Materialet burimore dhe dëshmitë e konsultimit janë përfshirë në këtë raport dhe/ose paraqiten si shtojca, me qëllim që dosja e aktit të jetë e plotë, e gjurmueshme dhe e përshtatshme për shqyrtim zyrtar.

Me respekt,

Irfan Peci

Kryesues i Grupit Punues

RAPORT

PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK

Draft-Rregullorja për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 02/2022 për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe shfuqizimin e Rregullores Nr. 04/2023

1. Qëllimi i raportit

Ky raport dokumenton procesin e konsultimit publik dhe shërben si material përcjellës për Kuvendin e Komunës gjatë shqyrtimit të Draft-Rregullores. Qëllimi i tij është të paraqesë në mënyrë të qartë se si është organizuar konsultimi, cilat çështje janë prezantuar, çfarë kanë ngritur qytetarët dhe palët e interesuara dhe cilat komente janë pranuar edhe pas takimit përmes postës elektronike.

Raporti nuk zëvendëson procesverbalin e diskutimit publik; përkundrazi, e sintetizon atë dhe e plotëson me dëshmitë e pjesëmarrjes, fotografitë dhe korrespondencën e pranuar gjatë afatit të konsultimit.

2. Baza e organizimit dhe periudha e konsultimit

Konsultimi publik është organizuar mbi bazën e Njoftimit për konsultim publik me nr. prot. 01-020/04-0038157-2/26-3, dt. 21.07.2026, si dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës Nr. 01-020/04-0038157-2/26, dt. 07.07.2026, me të cilin është formuar Grupi Punues për hartimin e plotësim-ndryshimit të Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave.

Qytetarëve dhe palëve të interesuara u është dhënë mundësia të marrin pjesë në diskutimin e drejtpërdrejtë dhe të dorëzojnë komente me shkrim deri më 07.08.2026 përmes adresës elektronike të kryesuesit të Grupit Punues.

3. Të dhënat e takimit publik

Data e diskutimit	03.08.2026 (e hënë)
Ora e fillimit	10:30
Ora e përfundimit	11:40
Vendi	Salla e Kuvendit, kati i parë, Komuna e Mitrovicës së Jugut
Kryesuesi	Irfan Peci – Kryesues i Grupit Punues
Procesmbajtësja	Blerta Dragaj
Pjesëmarrja	21 pjesëmarrës të evidentuar me emër dhe nënshkrim
Afati për komente me shkrim	Deri më 07.08.2026

4. Zhvillimi i diskutimit publik

Takimi u hap me prezantimin e qëllimit të konsultimit dhe të arsyes së inicimit të plotësim-ndryshimit. Drejtoresha e Drejtorisë për Mbrojtjen e Mjedisit, znj. Arjeta Beqiri Hyseni, sqaroi se procesi lidhet edhe me kërkesën e KRM “UNITETI” për rishikimin e rregullores dhe të tarifave.

Kryesuesi i Grupit Punues, z. Irfan Peci, prezantoi punën e bërë nga Grupi Punues dhe sqaroi se rishikimi është shqyrtuar në kontekst të ndryshimeve ekonomike, inflacionit dhe rritjes së pagës minimale. U prezantua se drafti trajton ndryshimin e dispozitave ekzistuese, shfuqizimin e plotësim-ndryshimit të vitit 2023, si dhe çështje operative të lidhura me pastrimin, kontejnerët dhe lokacionet me mbeturina të hedhura jashtë sistemit të organizuar. Po ashtu, u sqarua se tarifat në draft paraqiten pa TVSH dhe se TVSH-ja zbatohet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Pas prezantimit u hap diskutimi me pjesëmarrësit. Diskutimi u fokusua jo vetëm në nivelin e tarifave, por në mënyrë të theksuar në cilësinë e shërbimit, vetëdijësimin e qytetarëve, gjendjen e kontejnerëve, deponimin e parregullt të mbeturinave dhe çështjen e lokacionit të Gërmovës.

5. Çështjet e diskutuara në Sallën e Kuvendit

Nr.	Folësi / roli	Çështja e ngritur / qëndrimi	Sqarimi ose vijimi i diskutimit
1	Isak Hajra Kryetar i fshatit Broboniq	Vlerësoi se çështjet e prezantuara janë të arsyeshme, por kërkoi që fokusi të jetë më i madh në pastërtinë e qytetit dhe në vetëdijesimin e qytetarëve që mbeturinat të mos hidhen jashtë vendeve të përcaktuara.	Arjeta Beqiri Hyseni theksoi se qëllimi i Komunës është krijimi i kushteve më të mira për qytetarët. Irfan Peci u pajtua me nevojën për vetëdijesim dhe organizim më të gjerë të qytetarëve.
2	Xhylazim Baliu Kryetar i fshatit Koprivë	Ngriti shqetësime lidhur me lokacionin/deponinë në Gërmovë, statusin dhe licencimin e saj, deponimin e mbeturinave jashtë kontrollit dhe mundësinë që qytetarët të kenë qasje më të rregulluar për deponim, me qëllim uljen e deponive ilegale.	Irfan Peci sqaroi se çështja e deponisë është më e ndërlikuar dhe duhet të trajtohet veçmas. Bahri Sinani informoi se Komuna është në diskutime për planin ndërkomunal dhe projekte që lidhen me deponinë e Gërmovës. Arjeta Beqiri Hyseni kërkoi bashkëpunim në evidentimin e deponive ilegale dhe raportimin e tyre te Drejtoria dhe inspektorati.
3	Xhylazim Baliu (vijim)	Shtoi shqetësimin për rrjedhat ujore pranë zonës së Gërmovës dhe mundësinë e ndikimit të deponisë në mjedisin përreth.	Çështja u evidentua si temë që kërkon trajtim të veçantë teknik dhe institucional, jashtë diskutimit të ngushtë për tarifën.
4	Tafil Peci KRM "UNITETI"	Theksoi se, nëse arrihet deri te rritja e tarifave, qytetarët duhet të marrin shërbim më të mirë dhe përmirësim të dukshëm të pastërtisë.	Qëndrimi u evidentua si kërkesë për lidhjen e rishikimit të tarifave me cilësinë, kapacitetet dhe vazhdimësinë e shërbimit.
5	Arjeta Beqiri Hyseni	Falënderoi pjesëmarrësit për pjesëmarrjen dhe kontributin në diskutim.	Takimi kaloi në fazën përmbyllëse.
6	Irfan Peci	Njoftoi pjesëmarrësit se rekomandimet dhe komentet mund të vazhdojnë të dërgohen me e-mail brenda afatit të konsultimit.	Afati i komunikimit me shkrim është mbajtur i hapur deri më 07.08.2026.

6. Vlerësimi i diskutimit të zhvilluar

Nga diskutimi rezultoi se interesimi i pjesëmarrësve ishte i orientuar kryesisht në efektin praktik të rregullores. Çështjet e ngritura lidhen ngushtë me kërkesën që çdo ndryshim tarifor të shoqërohet me shërbim më të rregullt, kontejnerë funksionalë, mjete më të përshtatshme, pastrim të lokacioneve me mbeturina dhe koordinim më të mirë ndërmjet Komunës dhe operatorit.

Gjatë diskutimit nuk u paraqit një propozim alternativ i detajuar për secilën tarifë. Pjesëmarrësit u fokusuan më shumë në standardin e shërbimit, përgjegjësitë operative dhe masat për parandalimin e deponimit të parregullt.

SHTOJCA 1 – LISTA E PJESËMARRJES

Në diskutimin publik janë evidentuar 21 pjesëmarrës me emër dhe nënshkrim. Më poshtë riprodhohet lista origjinale e nënshkruar, e cila është pjesë e dosjes së konsultimit publik.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Nr. 01-020/04-0038157-2/26-3 dt. 03.08.2026

Mitrovicë

Lista e pjesëmarrjes për konsultim publik të Draft Rregullores për plotësim dhe ndryshim të Rregullores Nr. 02/2022 Për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Mitrovicës së Jugut dhe shfuqizimin e Rregullores Nr. 04/2023 Për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 02/2022 Për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Mitrovicës së Jugut

Nr.	Emri e Mbiemri	Datë	Nënshkrimi
1.	ARTAN XHAKA	03.08.2026	[Signature]
2.	MEMO HECENI	03.08.2026	[Signature]
3.	Bleta Dragaj	03.08.2026	[Signature]
4.	Eliza Delija	03.08.2026	[Signature]
5.	Vlora Bejtë	03.08.2026	[Signature]
6.	ISAK HAJRA	03.08.2026	[Signature]
7.	XHAJAZA BAKU	03.08.2026	[Signature]
8.	AMIR KEJMENDI	03.08.2026	[Signature]
9.	Orgesa Peci	03.08.2026	[Signature]
10.	Safije Rustin Peci	03.08.2026	[Signature]
11.	Elda Ahmeti	03.08.2026	[Signature]
12.	Veset Peci	03.08.2026	[Signature]
13.	Tafir Peci	03.08.2026	[Signature]
14.	Emira Delia Rexha	03.08.2026	[Signature]
15.	Ghaibe Gholizi	03.08.2026	[Signature]
16.	Fikim Jusufi	03.08.2026	[Signature]
17.	LIRI DONA AHMETAJ	03.08.2026	[Signature]
18.	TEUTA BAJRA	03.08.2026	[Signature]
19.	ARTANA SEHANI	03.08.2026	[Signature]
20.	Rona Rexha	03.08.2026	[Signature]
21.	CONXHE PEEKAJ	03.08.2026	[Signature]
22.		03.08.2026	
23.		03.08.2026	
24.		03.08.2026	
25.		03.08.2026	
26.		03.08.2026	
27.		03.08.2026	
28.		03.08.2026	
29.		03.08.2026	
30.		03.08.2026	
31.		03.08.2026	
32.		03.08.2026	
33.		03.08.2026	
34.		03.08.2026	

Mitrovicë

Kryesuesi i Komisionit

Irfan Peci

Figura 1. Lista origjinale e pjesëmarrjes, dt. 03.08.2026.

SHTOJCA 2 – FOTO-DOKUMENTIMI NGA DISKUTIMI PUBLIK

Fotografitë në vijim dokumentojnë prezantimin e Draft-Rregullores, pjesëmarrjen dhe zhvillimin e diskutimit në Sallën e Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Jugut.



Foto 1. Prezantimi i Draft-Rregullores dhe tarifave të propozuara.




Foto 2. Prezantimi i tarifave për konsumatorët shtëpiak (pa TVSH).



Foto 3. Prezantimi i ndryshimeve të propozuara në Shtojcën 1 – tarifat.



Foto 4. Pjesëmarrës gjatë zhvillimit të diskutimit publik.

SHTOJCA 2 – FOTO-DOKUMENTIMI (VIJIM)



Foto 5. Përfaqësues dhe qytetarë gjatë konsultimit.



Foto 6. Pamje e përgjithshme e Sallës së Kuvendit.



Foto 7. Diskutimi ndërmjet prezantuesve dhe pjesëmarrësve.




Foto 8. Pamje nga zhvillimi i konsultimit publik.

7. KOMENTET E PRANUARA ME E-MAIL

Pas diskutimit publik, brenda afatit të konsultimit, janë pranuar tri komente me postë elektronike. Tabela në vijim paraqet dërguesin, datën dhe orën e pranimit, subjektin dhe përmbajtjen e komentit.

Nr.	Dërguesi	Data / ora	Subjekti	Përmbajtja e komentit
1	Xhelal Shabani <xh.shabani2@gmail.com>	04.08.2026 08:23	Pershendetje	“Sa i përket rregullores që e keni qit në diskutim publik, mendimi im është që të fokusoheni më shumë te cilësia e shërbimit, të ketë kontejnerë dhe kamiona të rinj dhe pastërti në qytet.”
2	Pik ART <pik-art@hotmail.com>	04.08.2026 09:36	Pershendetje e kam lexuar rregulloren tuaj !	Kërkon më shumë vëmendje ndaj pastrimit dhe mirëmbajtjes së kontejnerëve, zëvendësimin e atyre të dëmtuar, intensifikimin e aktiviteteve për largimin e deponive ilegale dhe larjen e rregullt të rrugëve, me qëllim rritjen e pastërtisë dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit.
3	Behar Prekazi <beharprekazi123@gmail.com>	07.08.2026 08:04	Pershendetje	“Sa i përket Rregullores për mbeturina, propozoj që mundësisht UNITETI të ofrojë shërbime më të mira, pajisje më moderne, kamion special dhe kontejner modern. Duhet të modernizohet kompania.”

8. Analiza e komenteve të pranuar me shkrim

Të tri komentet e pranuar me e-mail kanë një emërues të përbashkët: kërkohet që rishikimi i kuadrit tarifor dhe rregullativ të shoqërohet me përmirësim të matshëm të shërbimit, modernizim të mjeteve, kamionë dhe kontejnerë më të mirë, mirëmbajtje dhe zëvendësim të kontejnerëve të dëmtuar, largim të deponive ilegale dhe rritje të pastërtisë së hapësirave publike. Këto komente janë në të njëjtën linjë me temat e ngritura në Sallën e Kuvendit dhe i përcillen Grupit Punues për trajtim gjatë finalizimit të draftit.

9. Përmbledhja e procesit dhe rekomandimi për procedim

Procesi i konsultimit publik ka përfshirë njoftimin publik, diskutimin e drejtpërdrejtë, evidentimin e pjesëmarrjes me nënshkrim, prezantimin e draftit dhe pranimin e komenteve me shkrim deri në përfundim të afatit. Komentet e pranuar janë fokusuar kryesisht në cilësinë e shërbimit, mjetet dhe pajisjet operative, kontejnerët dhe trajtimin e mbeturinave jashtë sistemit të organizuar.

Duke marrë parasysh zhvillimin e konsultimit dhe materialet e evidentuara, rekomandohet që Grupi Punues, pas harmonizimit teknik-juridik dhe evidentimit përfundimtar të komenteve, ta procedojë Draft-Rregulloren për shqyrtim dhe vendimmarrje në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

10. Dokumentet që i bashkëlidhen / janë pjesë e dosjes

Dosja përfshin: procesverbalin e diskutimit publik të dt. 03.08.2026; listën origjinale të pjesëmarrjes me nënshkrime; njoftimin për konsultim publik; Draft-Rregulloren e publikuar; komentet e pranuar me e-mail; dhe foto-dokumentimin nga diskutimi publik.

Kryesuesi i Grupit Punues

Irfan Peci

Procesmbajtësja

Blerta Dragaj

SHTOJCA 3 – DËSHMITË E KOMENTEVE TË PRANUARA ME E-MAIL

Në vijim paraqiten kopjet e e-mail-eve të pranuara gjatë afatit të konsultimit publik.

Irfan Peci

From: Xhelal Shabani <xh.shabani2@gmail.com>
Sent: Tuesday, August 4, 2026 8:23 AM
To: Irfan Peci
Subject: Pershendetje

Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

I nderuar,

Sa i perket rregullores qe e kenj qit ne diskutim publik, mendimi im eshte qe te fokusoheni me shume te cilësia e sherbimit, te ketë kontenjer dhe kamiona të rinjë dhe pasterti në qytet.

Me respekt.

SHTOJCA 3 – DËSHMITË E E-MAIL-EVE (VIJIM)

Irfan Peci

From: Pik ART <pik-art@hotmail.com>
Sent: Tuesday, August 4, 2026 9:36 AM
To: Irfan Peci
Subject: Pershendetje e kam lexuar rregulloren tuaj !

Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

Ju lutem që t'i kushtoni më shumë vëmendje pastrimit dhe mirëmbajtjes së kontejnerëve, si dhe zëvendësimit të atyre që janë dëmtuar, pasi një pjesë e konsiderueshme e tyre në qytet janë në gjendje jo të mirë. Gjithashtu, do të ishte e nevojshme të intensifikohen aktivitetet për largimin e deponive ilegale dhe larjen e rregullt të rrugëve, me qëllim të rritjes së pastërtisë dhe përmirësimit të cilësisë së mjedisit për qytetarët.

Get [Outlook for iOS](#)

SHTOJCA 3 – DËSHMITË E E-MAIL-EVE (VIJIM)

Irfan Peci

From: Behar Prekazi <beharprekazi123@gmail.com>
Sent: Friday, August 7, 2026 8:04 AM
To: Irfan Peci
Subject: Pershendetje

Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

I nderuar,

Sa i perket Rregullores per mbeturina, propozoj qe mundesisht UNITETI te ofroj sherbime ma te mira, paisje ma moderne, kamion special dhe kktenjer modern.

Duhet te modernizohet kompania.

Me respekt,
Behar Prekazi